

Syllabusi i lëndës

Lënda: KUR'AN IV

Programi i studimit: Studime Islame

Numri i ECTS kredive: 6

Statusi i lëndës: Obligative

Kodi i lëndës: 408

Fondi i orëve: 3+2

Viti akademik: 2026-2027

Semestri: VIII

Mësimdhënësi: Dr. Hfz. Safet Hoxha

Qëllimi i lëndës

Qëllimi i lëndës është ti njohë studentët me disa specifika të formes përfundimtare të mus hafve të diskriptuar nga Othmani r.a. si vokalizmi ,pikësimi tyre, ndarja në ajete numri i tyre sipas shkollave të numrimit si dhe të fitohet njohuri e përgjithshme rreth asaj që është e preferuar ,e lejuar e ndaluar e urrejtur në lexim të Kuranit në prekje apo bartje të mus hafit etj.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Të përvetsojë rregullat e përgjithshme për lexim dhe sjellje me mus hafin.

Të njohë gjendjen e mëparshme të mus hafeve. Të njihet më format përfundimtare të shkrimit.

Të rritë kureshtjen për mësim përmendsh të Kuranit .Të njihet me leximet dhe mekamet e këndimit të ezanit sipas vakteve.

Të dijë ti dalloj leximet e Kuranit sipas mekameve.

Të njohë meselet që preferohen së vepruari në lexim të Kuranit.Të njihet me gjestet dhe veprimet e urrejtura gjatë leximit të Kuranit.

Të arrijë një kulturë të mirësjelljes me Kuranin që është e pranuar me hadithet e Pejgamberit a.s.etj..

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet përmes ligjeratave, këndimit nga profesori ,leximi nga studentët,leximi dhe kontrolli nga vetë studentët,ndëgjimi nga profesonist të këndimit muxheved,stimulimit të studentëve në lexime të lira, seminareve etj...

Përmbajtja e lëndës:

Leksionet janë të bazuara në kapitujt si ma poshtë,unë i ndjeki kapitujt nga librat në gjuhen arabe por studentët mund të bazohën në ligjeratat e mbajtura në klasë si dhe pjesrishtë nga literatura e përkthyer apo autoriale në disa punime të bëra në vitet e kaluara dhe gjatë vitit paraprak.

Java e parë: Njohje me plan programin, njohuri rreth shenjzimit dhe vokalizimit të Kuranit, numri sipas shkollave të numërimit,rregulla të përgjithshme për lexuesin ,ndëgjuesin ,studiuesin e Kuranit, rregulla të veqanta për mus hafin dhe lexuesit e ti.

Literatura: (Resmul mus haf dhe et-tibjan fi hamletil Kuran)

Java e parë: Shenjëzimi dhe vokalizimi i Kuranit, definimi i fjales dabt, shekl dhe nukat . Dallimi mes pikave të shkronjave dhe zanoreve. Shkaqet e vokalizimit dhe pikësimit të mus hafeve dhe kush e inicoi këtë çështje dhe kush e kreu.

Literatura: (Resmul mus haf fq.87-89]

Java e parë: Shkaqet e vokalizimit dhe pikësimit të mus hafeve dhe kush e inicoi këtë çështje dhe kush e kreu.

Literatura: (Resmul mus haf fq.87-89]

Java e dytë: Pjesëzimi i mus hafeve në xhuza , hizba dhe në ndarje tjera, kush e bëri këtë ndareje i pari. Mus hafi i parë në botë. Rregullat përfundimtare të shkrimit në mus hafe.

Literatura: (Po aty fq.90-95)

Java e dytë: Format e sukunit mbi elif dhe domethënja e çdo forme të tij, mënyra e shkrimit të tenvinit para rregullave të texhvidit, vendosja e elifit, vavit dhe jaunit te vogël dhe domethënja e tyre, vendosja e shkronjës sin mbi dhe nën shkronjën sadun.

Literatura: (Po aty fq.96-103)

Java e dytë:Lexim me analiz të rregullave sipas rivajeteve të leximit.

Java e tretë: Fjalët që Hafsi dallohet nga të tjerët në lexim si, sekteja, fjala <dufin> në suren Rumë, leximi me imale, me tes hil,me ishmamë dhe nakël. Shenjat e ndaljes nëpër mus hafe të ndryshme .

Literatura: (Po aty 97-101 dhe fundi nëpër mus hafe)

Java e tretë: Adul ajeti shkenca e numërimit të ajeteve . Interesimi për numërin e ajeteve, hadithet e Pejgamberit a.s që përcaktojnë numërin e veçantë të ajeteve. Kushtëzimi i disa obligimeve sipas numrit të ajeteve dhe lidhshmërija e disa leximeve me fundin e ajeteve

Literatura: (Sherh nadhimetu zuhr fq.14-19)

Java e tretë:Ushtime të leximit muxheved

Java e katërt: El fasiletu fundi i ajetit, bazat sipas të cilave është përcaktuar fundi i ajetit shkollat më të njohura që u morën me numrin e ajeteve dhe numri sipas së cilës shkolle. Shembuj nga disa sure të Kuranit .

Literature: (Po aty fq.20-25)

Java e katërt: Hadithe rreth vlerës së mësimin të Kuranit përmendsh, disa rregulla për mësuesin e Kuranit dhe nxënësit e tij, etika që duhet të ketë bartësi e Kuranit, nderimi që duhet bërë hafizave.

Literatura: (Po aty fq.11-45)

Java e katërt:Ushtrime të leximit muxheved

Java e pestë: Marrja e Kuranit si mjet për të jetuar prej ti, pagesa për mësim të Kuranit dhe mendimet e dijetarëve për këtë çështje .

Literatura: (Po aty fq.50-53)

Java e pestë: Leximi i Kuranit për një natë dhe një ditë, leximi për tri ditë, një javë, 15 ditë, një muaj, 40 ditë dhe më së paku 2 herë në vitë. Mëkati i harresës së Kuranit.

Literatura: (Po aty fq.54-63)

Java e pestë:Ushtrime të leximit muxheved

Java e gjashtë: Qka preferohet para leximit të Kuranit, larja e dhëmbëve, abdesti, vendi i pastër, të kthyer nga kibla, leximi i istiadhes dhe besmeles, të përqëndruarit në lexim me vëmendje, të lexuarit rrjedhshëm, të lutet në vendet e përshtatshme për lutje, të largoj levizjet dhe gjestet e kota gjatë leximit.

Literatura: (Po aty fq.69-72)

Java e gjashtë: Vendet ku urrehet leximi i Kuranit, si ahër, torishtë, leximi në banjo, në rrugë, leximi në gjuhë tjetër dhe leximi me shkronja jo arabe.

Literatura: (fq.74-76 dhe 93-94)

Java e gjashtë:Ushtrime të leximit muxheved

Java e shtatë: Preferimi i leximit me renditje, leximi përmendësh,leximi pamorë, leximi grupishtë, leximi një pas një, ngritja e zërit në lexim dhe zbukurimi I zërit.

Literature: (Po aty fq.95-111)

Java e shtatë: Leximi sipas vlerës së vendit dhe kohës, zgjedhja e pjesëve me kuptim të plotë, tematike etj.. Përzgjedhja e lexuesit më të mire.

Literature: (Po aty fq.112-114)

Java e shtatë:Ushtrime të leximit në mekamin Bejati

Java e tetë: Leximi i ezanit, ikamet ,tekbirave dhe telbijes.

Literatura: (Haku tilave fq.297-309)

Java e tetë: Leximi Kuranit sipas mekameve si; bejati, sabah, rast etj.

Literatura: (Fenu et-tertil fq.180-185)

Java e tetë:Ushtrime të leximit në mekamin Rast

Java e nëntë: Gjendje në të cilat nuk preferohet leximi I Kuranit. Disa risi jo të mira në lexim të Kuranit.

Literatura: (Et-tibijan fi hameleti el Kuran fq.116-117)

Java e nëntë: Disa mesele që është e nevojshme të dihen. Leximi që ka për qëllim ndonjë bisedë, nderimi i ulemave dhe lexuesve të Kuranit.

Literatura: (Po aty fq.118-123)

Java e nëntë:Ushtrime të leximit në mekamin Sika

Java e dhjetë: Çështje që lidhen për leximin në namaz, si leximi i dy sureve, leximi me zë, sexhdja e leximit (tilavetit), numëri i sexhdeve, kush obligohet për sexhde etj.

Literatura: (Po aty fq.126-132)

Java e dhjetë: Sexhdeja e leximit në namaz, në mjetet e udhëtimit, mënyra e sexhdes dhe çka lexohet në të.

Literature: (Po aty fq.134-145)

Java e dhjetë:Ushtrime të leximit në mekamin Nehavend

Java e njëmbdhjetë: Sjellja në përgjithësi e njerëzve me Kuranin, ndalimi i komentimit pa dijeni, polemika pa të drejtë rreth Kuranit. Nuk lejohet të thuhet kam harruar këtë ajetë.

Literatura: (Po aty fq.163-169)

Java e njëmbdhjetë: Nuk i ndalohet pa besimtarit ta ndëgjojë Kuranin. Dispozitat rreth shkrimit të Kuranit në gjësende të ndryshme, fryerja e ujit me Kuran për shërim.

Literatura: (Po aty fq.172-173 dhe 183-185)

Java e njëmbdhjetë:Ushtrime të leximit në mekamin Hixhazi

Java e dymbdhjetë: Ajetet dhe suret që preferohen së lexuari në kohë dhe gjendje të caktuara.

Literatura: (Po aty fq.176-182)

Java e dymbdhjetë: Vlera e shkronjësit të Kuranit dhe nderimi i mus hafit.

Java e dymbdhjetë:Ushtrime të leximit në mekamin Saba

Java e trembdhjetë:Kujt i lejohet prekja, bartja dhe leximi i mus hafit.

Java e trembdhjetë:Libra që përmbajn ajete dhe sjellja e fëmijës me mus haf. Shitblerja e mus hafit.

Literatura: (Po aty fq.186-197)

Java e trembdhjetë:Ushtrime të leximit në mekamin Axhem

Java e katërbdhjetë: Mënyra e mësimi të Kuranit përmendsh dhe praktikat e njohura në botën islame.

Literatura:Delilul hajran li hifdhil el-Kuran (fq.5- 40)Ahlak hameleti el-Kuran lil Axhurij (fq.10-25)

Java e katermbdhjetë:Shkollat e hifzit në trojet shqiptare dhe më gjerë.

Java e katermbdhjetë:Ushtrime të këndimit në dy tri mekame

Java e pesmbdhjetë:Hafizat dhe kurrat më të njohur në trojet shqiptare.

Java e pesmbdhjetë:Hafizat dhe kurrat më të njohur në boten islame

Java e pesmbdhjetë:Përmbyllje e planprogramit.

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pershkruani formen e vleresimit, p.sh

Pjesemarja dhe aktiviteti gjate ores... pike

Punimi seminarik...pike

Provimi final...pike

Totali... pike

Standardi i notimit ne FSI:

10= 90% - 100%

9= 80 – 89

8=70 – 79

7=60 – 69

6=50 - 59

Literatura obliguese:

1".Et-tibjan fi hamletil Kuran", Sherefedin en-Nevevi

2."Sherh nadhimetu z-Zuhr",Abdul Fetah el kadi

3." Haku tilaveti",Husni esh-shejh Othman

- 4."Golde Pegas" Nibil f. Safvet
- 5."Studimi dhe këndimi i Kuranit", Ibrahim Terbinjac
- 6."Delil hajran li hifdhil Kuran" Mezahim Talib el Ani
- 7."Ahlak hameletil Kuran" lil Axhurij ,Ebu Beker Husejn Abdullah el bagdadi

Literatura jo obliguese:

- 1."Sherh al alametu el muhalalati", Ridvan bin muhamed sylejman
- 2."El kitabul xhami lifadailu el Kuran el kerim", mues-setu al el Bejt el Melekijetu.
- 3."El itkan fi ulumil Kuran", Es-Sujuti.
- 4."El burhan fi ulumil Kuran", Ez-Zerkeshi.
- 5."Menahilu el urfan fi ulumil Kuran", Muhamed Abdulad him Zerkani.
- 6."El bejan lihukm kiraetil Kuran el kerim bil elhan", Ejmen Rushdi Suvejd.
- 7."Fenu et-tertil ve ulumihi", Ahmed bin Ahmed bin Muhamed bin Abdullah et-tavil.